

LINDITË SEJDIU-RUGOVA**PIKËPAMJET SINTAKSORE TË SPIRO FLOQIT**

Spiro Floqi solli në shqipen një frymë gjysmëstrukturaliste dhe gjysmësemantike të studimeve sintaksore, sidomos në punimet e tij të fundit të viteve 70-të, ndonëse jo plotësisht të liruara nga fryma e logjikës dhe e tradicionalizmit që atëbotë dominonte në studimet gramatikore në përgjithësi. Idetë e tij prej sintaksologu ishin mjaft përparimtare për kohën kur jetoi dhe veptoi, duke i marrë parasysh rrethanat shoqërore, në të cilat zhvillohej shkenca shqiptare në përgjithësi.

Karakteristike për punimet e tij është bollshmëria e korpusit, kryesisht letrar, për çështje të analizës gjuhësore, pastaj terminologjia e pasur dhe shumë moderne për kohën kur i shkroi punimet e tij, mbështetja teorike e autorit në tekste gramatikore të gjuhëve të huaja, kryesisht nëpërmjet përkthimeve të tyre nga rusishtja dhe frëngjishtja, kreativiteti në shtjellimin e ideve të reja të kohës dhe përshtatja e tyre në shqipen, si dhe shterimi deri në fund i problemeve gjuhësore, pa lënë vend shumë hapësirë për ambiguitet apo dyshim.

Qysh në vitin 1967, në vëllimin nr. 3 të *Studimeve Filologjike*, Floqi flet për disa tipa semantiko-strukturorë të periudhës me fjali të varur pa lidhje korelative. Ai jo vetëm që i konsideron të pamjaftueshme klasifikimet e mëparshme dhe të disa bashkëkohësve të tij sa i përket klasifikimit të periudhës me nënrenditje në përgjithësi, por edhe jep propozime konkrete, të cilat sot e gjithë ditën janë të krahasueshme me klasifikimet që i bëjnë periudhës me nënrenditje gramatikat bashkëkohore të anglishtes apo edhe të gjermanishtes të pas vitit 2000. Floqi atëbotë, duke u nisur nga parime semantike dhe strukturore pra, duke u nisur nga mjeti i lidhjes dhe nga kuptimi shumë i ngushtë që përcjell fjalitë e varur në raport me fjalitë kryesore, arrin të dallojë tipin fthillëzgjës lidhëzor dhe përemëror, si dhe tipin lidhëzor qëllimor, kohor, shkakor, kushtor dhe lejt.

Një klasifikim i tillë, që niset nga struktura e fjalisë së varur (pra, nga lloji i mjetit lidhës) dhe nga kuptimi i mjetit lidhës (në rastin konkret jokorelativ, ose siç quhet ndryshe *unfused relative* në anglishten) është i afërt edhe me studimet e sotme strukturore dhe gjenerative të shqipes. Klasifikimi i tillë i periudhës me nënrenditje, duke u mbështetur kryesisht në kriterin strukturor dhe semantik, e bën më të lehtë përshkrimin gjuhësor dhe e eliminon ambiguitetin funksional të strukturave më komplekse se fjalitë e thjeshtë.

Përpos çështjes së klasifikimit të fjalitë të varura, si dhe të rendit të fjalëve në fjali e periudhë, Floqi diskuton edhe për periudhën me fjali të varur kryefjalore, në kuadër të së cilës vlen të përmendet tipi përemëror (siç e quan

ai korelativ), e që sipas kritereve të sotme gramatikore nuk është fjali kryefjalore por vetëm një fjali lidhore që përcakton një përemër vector a një përemër të substantivuar. Kështu fjalitë e tipit *Ai që erdhi në klasë ishte Guri!*, Floqi e kategorizon si fjali kryefjalore ndonëse në këtë fjali kryefjala është shprehur me një sintagmë emërore që përbëhet nga koka *Ai* dhe nga fjalia lidhore që e shtjellon dhe e konkretizon më tej kuptimin e kësaj koke. Floqi përpiket ta zbatojë kriterin semantik për qartësimin e pozicionit të tij, duke thënë se përemri *ai* pa fjalinë e varur nuk ka brendi reale konkrete, por ai e anashkalon idenë se edhe në mungesë të fjalisë së varur lidhore koka *ai* lidhet me foljen këpujore *ishte* edhe pa ndihmën e fjalisë së varur (*që erdhi në klasë*). Shembujt që merr janë kryesisht proverba dhe fjalë të urta që janë krijuar si të tilla në mënyrë që të pranohen si të pandara kuptimisht dhe nuk janë shembuj tipikë të shpjegimit të këtyre fjalive nga aspekti strukturor (Floqi, SF, 3, 1967, f. 21-30).

Një punim tjetër me ndikim nga studimet e shumta të Floqit është edhe ai i vitit 1968, që ka të bëjë me çështjen e teorisë së togfjalëshit në shqipe (Floqi, SF 1, 1968, f. 75-84).

Sipas Floqit, termi togfjalësh në shqipe “ka një farë lidhje me terma pak a shumë adekuatë të gjuhëve të tjera indoevropiane”, siç janë termat sintagmë ose grup fjalësh, dhe gjithnjë sipas tij, togfjalëshi përbëhet, së paku, prej dy fjalësh shënuese (pra, përjashtohen fjalët shërbyese), dhe këto fjalë shënuese i quan gjymtyrë të togfjalëshit. Floqi thekson se njëra gjymtyrë e togfjalëshit është gramatikisht kryesore ndërsa tjetra është e varur. Vetëm në këtë pikë, te varësia, Floqi i afrohet shpjegimeve perëndimore të sintagmës së Sosyrit dhe të Blumfeldit, apo edhe frazës së gjermanishtes. Pra, klasifikimi i njëjës gjymtyrë si kryesore dhe i tjetrës si gjymtyrë e varur, bën që nënrenditja të jetë tipar themelor i kësaj lidhjeje gramatikore. Natyrisht, një shpjegim i tillë ngushtohet kur këtij përkufizimi i shtohet shpjegimi “*togfjalëshi krijohet nga dy fjalë shënuese*” dhe njëkohësisht krahasohet me sintagmën. *Sintagma* ose *fraza* (këtu nuk është fjala për periudhën) ndërkaq, paraqesin një përbërës të fjalisë, i cili përmban në vete më shumë se një fjalë, respektivisht një fjalë qendrore dhe më të rëndësishme, e cila argumentohet dhe përshkruhet nga fjalët që e shoqërojnë dhe të cilat e shtjellojnë “kontributin” e asaj fjale në fjali (duke mos i llogaritur këtu rastet kur sintagmat përbëhen nga një fjalë e vetme dhe bëjnë pjesë në të ashtuquajturin “degëzim njëjës”). Kategoritë leksikore përputhen me tipat korrespondues të sintagmave ose të frazave që, në të vërtetë, paraqesin zgjerime të tyre (Huddlestone / Pullum, 2002, f. 20-23). Një element shumë i rëndësishëm në ndërtimin e sintagmës është mosekzistenca e lidhjes kryefjalë-kallëzues, dhe një gjë e tillë i ka përjashtuar automatikisht të ashtuquajturit togfjalësh predikativë (Rugova, 2005, ...). Pra, në momentin që brenda një sintagme krijojmë marrëdhënie kryefjalë-kallëzues, kemi ndërtuar

një fjali të thjeshtë. Në shpjegimin që jepet për togfjalëshat në *Gramatikën e gjuhës shqipe II*, bashkimet kallëzuesore nuk veçohen nga togfjalëshat dhe mbështetet qëndrimi i ekzistencës së togfjalëshave predikativë, duke mos i konsideruar këta të fundit fjali (p.sh.: *Era ndaloi. Nëna iku.* etj.) (Gramatika II, 1997, f. 81-82). Edhe Floqi nuk bën përjashtim në këtë rrafsh¹.

Duhet theksuar se është i pritshëm ky përkufizim i Floqit për togfjalëshin, gjithashtu është e kuptueshme që të jetë mjaft i ngjashëm me përkufizimin që jepet në Gramatikën e Akademisë të viteve '90 meqë vetë Floqi qe pjesë e grupit të autorëve që e shkruan këtë gramatikë. Floqi, ndërkaq, në po të njëjtin punim, shpeshherë i kundërshton idetë e akademikut rus Vinogradov sa u përket të ashtuquajturve togfjalësha të bashkërenditur. Floqi, ngjashëm me gjuhëtarët shqiptarë të asaj periudhe, i qëndron besnik teorisë së togfjalëshit si teori, por një përkufizim i tillë i togfjalëshit "si bashkim i dy a më shumë fjalëve kuptimplota apo shënjuese" e hedh poshtë autonominë e ndërtimeve me parafjalë në gjuhën shqipe si dhe të konstrukteve determinative, të cilat e përbëjnë bazën e studimeve strukturaliste gjuhësore në sintaksë. Sintagmat parafjalore dhe ato determinative të tipit (*pothuajse të gjithë, shumë nga ata*, etj.) në teorinë e sintagmës konsiderohen të jenë sintagma të krahasueshme funksionalisht me ato të fjalëve kuptimplota. Aty parafjala e luan rolin e kokës (Huddleston / Pullum, 2002, f. 58) dhe, pjesa që pason, paraqet objektin e parafjalës, si p.sh. në *Londër, drejt nesh, prej tij, me dy nga nxënësit*, etj. Pikëpamjet e ndryshme të Floqit në raport me sintagmat parafjalore do të mund t'i arsyetonim me ndikimin e madh që pati literatura shkencore sovjetike në studimet gjuhësore shqiptare të asaj kohe.

Ndryshe nga idetë e Floqit për togfjalëshin, punimi i tij që i shtjellon modelet e fjalisë dëftore në shqipen letrare, i vitit 1978, del në frymën moderne të kategorizimit të foljeve në bazë të valencës së tyre dhe të kategorizimit të fjalive në bazë të klasifikimit të foljeve që i përbëjnë ato fjali (Floqi, SF 4, 1978, f. 25-51). Duke u mbështetur në teorinë strukturaliste të Tesnierit, sipas së cilës folja / kallëzues paraqet komponentin kryesor të fjalisë dhe i parakupton edhe komponentët e tjerë të domosdoshëm të një fjalie të caktuar, komponentët fakultativë dhe komponentët e papranueshëm të një modeli të caktuar. Floqi thekson se në të vërtetë është valenca e foljes ajo që e kushtëzon kombinatorikën e përdorimit të aktantëve të saj të domosdoshëm dhe fakultativë.

¹ Sipas teorisë universale gjuhësore që mbështeten në analizën e fjalisë në përbërës të drejtpërdrejtë (nga e cila më vonë zuri fill edhe gjenerativizmi), sintagmat përbëhen nga koka (fjala bosht) dhe elementet e varura të saj. Varësia është term i gjerë në këtë aspekt dhe duhet dalluar dy nëntipe të varësisë në këtë rrafsh: parapërcaktorin (premodifier), i cili mund t'i paravijet kokës së sintagmës, dhe paspërcaktorin (postmodifier), i cili i pasvijet kokës së sintagmës.

Një klasifikim i tillë i modeleve që niset nga fjalia e ka zanafillën në teorinë e *Basic Sentence Patterns*, të zhvilluar kryesisht në gjuhët më analitike se shqipja, ku rendi i fjalëve në fjali shpeshherë shndërrohet në kategori gramatikore pikërisht për shkak të rëndësisë që ka dhe për shkak të mungesës së fleksionit gjuhësor. Megjithatë, rëndësia e krijimit të modeleve në një gjuhë të caktuar u bë e domosdoshme më pas në shpjegimin sa më të saktë të shumë strukturave të ndërlikuara gjuhësore në procesin e mësimdhënies së gjuhëve: tentohet që të gjitha fjalitë e mundshme të një gjuhë të futen në modele të prera nga foljet leksikore të asaj gjuhe.

Modelet e tilla Floqi i quan njësi minimale themelore strukturore të cilat, duke u mbështetur në një material fjalësor konkret, kumtojnë diçka për një fragment të caktuar të realitetit (Floqi, SF 4, 1978, f. 25). Floqi i jep këto modele duke u mbështetur në terma të pjesëve të ligjëratës, ndryshe nga gjymtyrët e fjalisë, në mënyrë që të jepen edhe hollësitë më të veçanta të foljes dhe të përbërësve të saj.

Floqi mendon se metoda më e mirë për ndërtimin e modeleve të tilla në një gjuhë është metoda e fshirjes me vizë, sipas së cilës eliminohen (fshihen) fjalitë konkrete (përbërësit që nuk janë të domosdoshëm nga pikëpamja semantike dhe gramatikore). Sipas tij, fjalia *Gazetari e vështronte herë pas here shoferin me bisht të syrit*. mund të thjeshtohet shumë lehtë në fjalinë *Gazetari vështronte shoferin*. dhe kështu arrihet deri te modeli i fjalisë i tipit N1 + folje kalimtare + N4, pra emër në rasën emërore, kallëzues dhe emër në rasën kallëzore, tipi që i përket, gjithnjë sipas tij, grupit të modeleve të fjalive dykryegjymtyrëshe.

Gjatë shpjegimit të strukturës me të cilat dalin këto modele fjalish, Floqi përpiket që nëpërmjet një terminologjie të tërë, të përshtatur në shqipen nga vetë ai (të tilla janë shkurtesat brenda modeleve: N për emër, pr për parafjalë, p/E për togun parafjalë / emër, etj.) të japë formulat përkatëse për çdo model veç e veç. Megjithatë, shumë më lehtë do ta kishte pasur po ta kishte marrë për bazë konceptin e sintagmës me një kokë apo me një fjalë bosht, sepse të gjitha elementet strukturore do të kishte mundur t'i ndante në sintagma, qofshin ato të thjeshta apo të përbëra. Në studimet e sotme të anglishtes dhe të gjermanishtes përdoret modeli i ndarjes së fjalisë në elemente funksionale, me të vetmin përjashtim që kallëzuesi nuk shprehet si i tillë por si folje, pasi klasifikimi i mëtejshëm i foljes në këpujore, jokalimtare, kalimtare e thjeshtë apo kalimtare e përbërë, përcakton llojin e elementeve funksionale që e pasojnë ose që i paraprijnë.

Floqi arrin t'i identifikojë rreth 30 modele fjalish me disa nëntipa, por nuk arrin ta thjeshtojë klasifikimin e këtyre modeleve siç zakonisht ndodh me modelet e fjalive në gjuhët e tjera. Me gjasë, klasifikimin e Floqit e bën më kompleks edhe natyra e topikës së shqipes si pasojë e flektivitetit gjuhësor dhe

të kategorizimit të pasur gramatikor. Floqi e shteron numrin e modeleve që sipas tij nuk kanë ndërlikime (modelet me gjymtyrë të veçuara, modelet me kallëzues të zgjeruar me konstrukte të pashtjelluara të foljeve si dhe modelet e frazeologjizuara) dhe e konsideron klasifikimin e tij të modeleve të përfunduar.

Floqi tërheq vëmendjen për dallimet strukturore të modeleve që semantikisht janë të afërta, të tipit *Nusja çalon* dhe *Nusja është e çalë*. Ai mendon se së pari duhet të përcaktohen nocionet dhe termat themelore të semantikës në gjuhën shqipe, në mënyrë që më pas të përshkruhen dhe të analizohen në më shumë hollësi modelet e fjalive të tilla. Një ide e tillë është mjaft inovatore për kohën dhe mjaft e afërt me teoritë e gramatikave moderne të ditëve të sotme.

Si përfundim, mund të konkludojmë se studimet e Spiro Floqit për sintaksën e shqipes ishin të larmishme dhe shumë prodhimore për kohën kur u krijuan dhe u botuan. Ai frymëzoi gjenerata të tëra pas tij dhe i orientoi drejt shpjegimit semantik të koncepteve sintaksore në shqipe, duke bërë përpjekje edhe për studime mbështetëse strukturore, por kryesisht të pasuksesshme dhe nën hijen e logjicizmit të kohës. Megjithatë, vepra e Spiro Floqit mbetet një burim i pashtershëm i dijes gramatikore dhe i konkretizimit shkencor ndër studiuesit shqiptarë.

BIBLIOGRAFI

- Gramatika e gjuhës shqipe II (Sintaksa)*, ASHRSH - grup autorësh, Tiranë, 1997.
- Rodney Huddleston / Geoffrey K. Pullum, *The Cambridge Grammar of the English Language*, Cambridge University Press, 2002.
- Spiro Floqi, *Çështje të teorisë së togfjalëshit në shqipen e sotme*, “Studime Filologjike”, nr. 1, 1968, f. 75-84.
- Spiro Floqi, *Disa tipe semantiko-strukturore të periudhës me fjali të varur pa lidhje korelative*, “Studime Filologjike”, nr. 3, 1967, f. 21-30.
- Spiro Floqi, *Disa vrojtme për rendin e fjalive në periudhë*, “Studime Filologjike”, nr. 3, 1976, f. 113 - 126.
- Spiro Floqi, *Mbi disa çështje të rendit të fjalëve në shqipen e sotme*, “Studime Filologjike”, nr. 2, 1969, f. 125 -144.
- Spiro Floqi, *Periudha me fjali të varur kryefjalore në shqipen e sotme II*, “Studime Filologjike”, nr. 4, 1965, f. 3-40.
- Spiro Floqi, *Periudha me fjali të varur rrjedhimore në shqipen e sotme*, “Studime Filologjike”, nr. 2, 1965, f. 55-102.
- Spiro Floqi, *Periudha me fjali të varur shkakore I*, “Studime Filologjike”, nr. 2, 1966, f. 3-42.

Spiro Floqi, *Periudha me fjali të varur shkakore II*, “Studime Filologjike”, nr. 3, 1966, f. 3-50.

Spiro Floqi, *Rreth modeleve të fjalisë në shqipen letrare*, “Studime Filologjike”, nr. 4, 1978, f. 25 - 52.

SUMMARY

SPIRO FLOQI ON ALBANIAN SYNTAX

Spiro Floqi gave a semi-structuralist and semi-semantic impact to the Albanian syntax, especially with his publications of the 70s, however, not completely free of logicism and traditionalism, generally dominant in the grammatical studies at that time. His syntactic overviews were very progressive for the time he lived and published, having in mind the social environment which influenced the development of the Albanian science as a whole.

Corpus variety, mainly literary one, rich and modern terminology for the time being, theoretical reliability of the articles influenced by the grammars of foreign languages through translations from French and Russian, creativity in exploring the new concepts and their fast adoption into Albanian, as well as exploitation of the linguistic problems without leaving space to ambiguity or doubtfulness are some of the main features typical for Floqi's articles. He inspired the new generations and oriented them towards the semantic concepts of the Albanian grammar. His structuralist articles remain unsuccessful and under the umbrella of logicism. However, his work remains one of the fundamental sources of the grammatical knowledge and scientific concretization in Albanology.